



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-21819

Dt. 16.11.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Ismet (Dervish) Kida** nga fshati Cermjan komuna e Gjakovës, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit me destinim Fermë për pula, me etazhitet P+0, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97 bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: Aplikuesit: Ismet (Dervish) Kida nga fshati Cermjan komuna e Gjakovës, ndërtimi i Objektit me destinim Fermë për pula, sipas projektit kryesor të prezentuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Urban dhe Vendimin për Kushtet Ndërtimore me nr. 07-351/01-18728, të datës 20.09.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale me numër 260/4, Z.K. Cërmjan, në pronësi të lartë përmendurit, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është P+0, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) të objektit $S = 350 \text{ m}^2$.

Përdhesa: (Sip,Bruto): $S = 350.00 \text{ m}^2$

II. Hartimin e projektit kryesor me destinim: ndërtimi i fermës për pula, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja projektuese "GONI – ING"- Suharekë.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

IV. Investitori është i obliguar që:

- Të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Pa pëlqimin e hartuesit të projektit ideor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspekcionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.



Arsy e t i m

Ismet (Dervish) Kida nga fshati Cërmjan komuna e Gjakovës, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-21819 të datës 13.10.2017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit me destinim Fermë për pula, me etazhitet P+0, në ngastrën kadastrale me numër 260/4, Z.K. Cërmjan, në pronësi të lartë përmendurit, siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 24.08.2017, të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 15.09.2017 në pronësi të (Ismet (Dervish) Kida nga Gfshati Cërmjan, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme me numër të lëndës 4643/17, të datës 15.09.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Vendimin për Kushte Ndërtimore, me nr. 07-351/01 –18728 të datës 20.09.2017, të lëshuar nga DUMM.
5. Pëlqimin Sanitar me nr.14/530/01-21255, dt.10.10.2017, nga Inspektoriati Sanitar Komunal, Drejtoria për Pune Inspektuese e Komunës së Gjakovës.
6. Pëlqimin mbi ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, me numër 08-320/01-20237 të datës 19.09.2017, të lëshuar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e Komunës së Gjakovës.
7. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430/a/687, të datës 21.08.2017.
8. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, nr.1509 të datës 13.09.2017.
9. Pëlqimin nga K.R.U. "Radoniqi" Sh.A. Gjakovë, nr.2567 të datës 06.09.2017.
10. Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, dt. 05.09.2017.
11. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Postën e Kosovës, filiali Gjakovë me datë 16.11.2017.
12. Projektin kryesor, në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga ndërmarrja projektuese "GONI – ING"- Suharekë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 899.50 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit,
- Arkivit.

Zyrtar i lartë për çështje juridike


Zenel Shabani, jur. i dipl.

U. D. Drejtori

Elida Bejtullahu, inxh. e dipl.e ark.

K.K. GJAKOVË
Z.K. :Cermjan
Parc. nr.260-4.

PLAN SITUACIONI



24.08.2017
GPS
Auto CAD 2004

P=1:500

Punoi : Rhetat F. Zhubi, inxh.dipl.i gjeod.

Vërtetoi : N.P.SH."GELI"
DREJTORI

Enok Hajdaraj




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT \ KOPIJA PLANA \ COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija \ Municipal Cadastral Office : GJAKOVË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona \ Cadastral Zone : Çermjan

Njësia \ Jedinica \ Unit	Tipi \ Vrsta \ Type	Sipërfaqja \ Poveršina \ Area m ²
P - 70705079 - 00260 - 4	Parcelë \ Parcela \ Parcel	885.0



Shkalla / Razmera /Scale: 1:2000

Punoi \ Obradio \ Created :
Data \ Data \ Date : 15.09.2017
Koha \ Vreme \ Time : 11:22:15
Nënshkrimi \ Potpis \ Signature:
Shënim \ Beleška \ Note :

Aprovoj \ Usvojio \ Approved : Drejtori \ Direktor \ Director
Nënshkrimi \ Potpis \ Signature: